

telefono 091 814 40 02/03
fax 091 814 44 46
e-mail dss-umc@ti.ch

web www.ti.ch/med

Repubblica e Cantone Ticino
Dipartimento della sanità e della socialità
Divisione della salute pubblica

**Ufficio del medico cantonale
6501 Bellinzona**

Funzionario
incaricato
091 814 39 97
alessandra.galfetti@ti.ch

telefono
e-mail

Prindërve të nxënësve
të shkollave të mesme tiçineze

Bellinzona
shkurt 2008



Ns. riferimento

Vs. riferimento

IC/AG

Vaksinimi kundër hepatitit B

Të dashur prindër,

Që nga viti 1999 Shërbimi i mjekësisë shkollore të Kantonit Tiçino promovon vaksinimin kundër hepatitit B (verdhëza, sarillëku) të të rinjëve mes moshës 11 e 15 vjeçare, sipas rekomandimeve të Zyrës federale të shëndetit publik. Në Tiçino, 65% e të rinjëve janë të vaksinuar kundër sarillëkut. Duke ju falënderuar personave të vaksinuar, rastet e hepatitit B akut janë zvogëluar shumë, por për ta ndaluar qarkullimin e virusit ende shumë të rinjë duhet vaksinuar.

Hepatitit B është një sëmundje e shkaktuar nga një virus që transmetohet nga personi në person para se të gjithash me rrugë seksuale (pa mbrojtje me prezervativ), shkëmbimin e gjilpërave mes përdoruesve të drogës apo me procedura të rrezikshme si piercing apo tatuazhe. Personi i infektuar me virusin e hepatitit B mund t'i shkaktoj, gjatë viteve, dëme të pashërueshme mëlqisë (cirozë e kancer e pastaj vdekja).

Vaksinimet janë akti mbrojtës më efikas që historia e mjekësisë ka njohur ndonjëherë. Vaksinimi kundër hepatitit B është përdorur që nga viti 1982 në mbi 500 milionë persona, pa mundur që të demonstrohen efekte anësore të rënda. Edhe lidhjet e mundshme mes vaksinimit dhe sëmundjeve degjenerative të sistemit nervor (skleroza multiple etj.), rreth të cilave kanë folur shumë mediat, janë përgënjeshtuar.

Vaksinimi kundër hepatitit B paguhet nga ana e sigurimit shëndetësor të obligueshëm: vetëm pjesëmarrja me 10% mbetet në ngarkesë të familjes, me përjashtim të ekzistimit të një paushalli fakoltativ.

Vaksinimi është shumë i këshillueshëm por jo obligativ. Mu për këtë kemi nevojë për gjithë perkrahjen tuaj në mënyrë që një numër sa më i madh i vajzave dhe djemve të shkollës së mesme të jetë i vaksinuar, me një vëmendje të veçantë për 14 vjeçarët: pasi të ketë përfunduar shkollimi i obligueshëm do të jetë më e vështirë tu japim të gjithëve një informacion adekuat.

Broshura e bashkangjitur jep shpjegime më të hollësishme rreth sëmundjes dhe rreth vaksinimit për të rinjtë. Mjeku juaj i familjes do të dijë t'ua heqë ç'do dyshim tuajin: drejtojuni atij për të gjitha informacionet rreth vaksinës, rreth mënyrave e kohës për të bërë vaksinimin. Edhe mjeku shkollor është në dispozicionin tuaj nëse dëshironi të mësoni më shumë si prindër. Zonja A. Galfetti (tel. 091 814 39 97), koordinatore e Shërbimit të mjekësisë shkollore, mund t'u tregojë mundësi të tjera informimi.

Përsërisim falënderimin tonë për angazhimin tuaj rreth shëndetit të të gjithë të rinjëve dhe popullatës së Kantonit.

Phëndetjet më të mira.

Il Medico cantonale
Dott. I. Cassis

Broshura rreth vaksinimit kundër hepatitit B